

Personale



# STATUTI I FONDACIONIT "SEA AL" MBROJTJA E FEMIJERISE DHE ADOLESHENCES

## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Qëllimi i Statutit

1. Ky statut përcakton rregullat e hollësishme të organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së Fondacionit "SEA AL", në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar, e ligjit Nr. 8798, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" si dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
2. Në mbështetje të Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat Jofitimprurëse" i ndryshuar, ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" si dhe dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, themeleusi hartoi dhe miratoi statutin e Fondacionit "SEA AL", me përmbajtjen e mëposhtme.
3. Organi më i lartë vendimmarrës i fondacionit dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë statut mund të ndryshoj përmbajtjen e këtij statuti.
4. Vendimi për ndryshimin e statutit të Fondacionit "SEA AL" depozitohet në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, sipas procedurave ligjore në fuqi.

### Neni 2 Përkufizime

1. Termat e përdorura në këtë statut do të kenë të njëjtat kuptime me ato të përcaktuara në ligjin Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar, në ligjin Nr. 8798, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" si dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë etj.
2. Në këtë statut termat e mëposhtëm do të kenë këtë kuptim:
  - a) "Mbledhje publike e fondeve", kuptohet mbledhja e fondeve me anë të fushatave sensibilizuese publike të një shkalle të gjerë.
  - b) "Veprimtari jofitimprurëse", kuptohet çdo veprimtari ekonomike ose joekonomike me kusht që të ardhurat ose pasuritë e fondacionit, kur ka të tilla, të përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në statutin e tij.
  - c) "Veprimtari në të mirë dhe interes të publikut", kuptohet çdo veprimtari që mbështet dhe zhvillon tek individit dhe shoqëria vlera shpirtërore dhe vlera të tjera humanitare, mbron jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron dhe realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështetje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin dhe zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik dhe shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira



dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut.

### Neni 3

#### Parime të përgjithshme

1. Fondacioni bazon veprimtarinë e tij në parimin e respektimit, të mbrojtjes dhe të zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parashikuara në Kushtetutë, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.
2. Fondacioni e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë të pavarur nga organet dhe interesat shtetërorë.
3. Fondacioni ka të drejta dhe përmbush detyrimet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, përveç kur parashikohet ndryshe në ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar ose në dispozita të tjera ligjore në fuqi.

## KREU II

### ORGANIZATA JOFITIMPRURËSE

#### Neni 4

##### Forma e organizimit

1. Fondacioni krijohet si një nga format e organizateve jofitimprurëse paanëtarësi.
2. Fondacioni është person juridik pa anëtarësi që ka për objekt arritjen e një qëllimi të ligjshëm me anë të destinimit të pasurisë në të mirë dhe interes të publikut në përputhje me ligjin Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar etj.
3. Fondacioni është një organizatë jofitimprurëse që ushtron aktivitetin e tij në territorin e Shqipërisë.

#### Neni 5

##### Regjistrimi dhe personaliteti juridik


1. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesi i fondacionit do të kryej të gjitha veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin këtij e tij ose mund të autorizojë një person të kryejë këto veprime në emër dhe për llogari të tij.
2. Fondacioni fiton personalitetin juridik pasi të jenë themeluar dhe regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligjin Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar, në ligjin Nr. 8798, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" etj.
3. Fondacioni pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjës ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së tij.
4. Personaliteti juridik i fondacionit mbaron në ditën kur vendimi i gjykatës për çregjistrimin e tij merr formë të prerë.

#### Neni 6

##### Emri, Sigla dhe Simboli

AE



- 
1. Emri i organizatës jofitimprurëse pa anëtarësi (fondacionit) është **Fondacioni "SEEAL"**.
  2. Për "Sauvegarde de l'Enfance et de l'Adolescence d'Albanie - Mbrojtja e fëmijëve dhe adoleshentëve në Shqipëri.
  3. Sigla e fondacionit është : "SEA AL".
  4. Emri dhe sigla e fondacionit janë pjesë e këtij statuti dhe duhet të figurojnë në të gjitha shkresat dhe korespondencën që dalin nga ky fondacion.
  5. Fondacioni ka vulën e tij, të cilën e përdor për dokumentat dhe raportet e ndryshme të lëshuara praj tij në drejtim të palëve të treta apo enteve/institucioneve të tjera publike dhe/ose private, dhe një kopje e saj do të depoziatohet në Gjyatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7  
Themeluesi

1. Fondacioni themelohet nga Z. Alain BOUCHON , të cilit i është dhënë mandati nga Këshilli Administrativ i shoqatës ADSEA01 për themelimin e tij si filial i ADSEA01, de nationalité française, i biri i Pierre BOUCHON , lindur në 28/01/1964 dhe me banim në 24, avenue des Anciens Combattants 01000 BOURG EN BRESSE, i identifikuar me pasaportë nr 06AH74262.
2. Këtij statuti i bashkëlidhen edhe dokumentet identifikues të themeluesit të tij.

Neni 8  
Selia dhe shtrirja territoriale

Fondacioni " SEA AL ", e ka seline e tij administrative ne Tirane :

Prane zyres te Z. Julien Roche - Twin Tower 1 .

1. Selia e fondacionit mund të ndryshohet me vendim të Bordit të Drejtorëve. Propozimi për ndryshimin e selisë mund të bëhet edhe nga Drejtori Ekzekutiv shoqëruar me një relacion shpjegues.
2. Fondacioni mund të themelojë degë në qendër ose në çdo njësi tjetër administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë. Degët e tij nuk janë persona juridikë të veçantë, por pjesë e organizatës. Propozimi për hapjen e degëve mund të bëhet edhe nga Drejtori Ekzekutiv, shoqëruar me një relacion shpjegues.
3. Fondacioni ka të drejtë të themelojnë degë, filiale etj., edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
4. Fondacioni ka të drejtë të ushtrojë aktivitetin e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
5. Fondacioni mund të jetë dhe antar i Organizatave të tjera jofitimprurëse vendase apo organizatave të tjera ndërkombëtare, të cilat kanë si synim përmbushjen e objektivave të këtij fondacioni.

Neni 9  
Qëllimi dhe fusha e veprimtarisë

1. Fondacioni është krijuar dhe do të ketë qëllimet e mëposhtëme:
  - a) Të ushtrojë veprimtari në të mirë dhe interes të publikut si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duke ju përmbajtur kërkesave ligjore dhe/ose rregullative ndaj këtij fondacioni dhe qëllimeve të tij.

AR






- b) Të marrë pjesë në mbrojtjen e fëmijëve dhe adoleshentëve.
- c) Tu vijë në ndihmë fëmijëve dhe adoleshentëve si dhe të rinjve madhorë të cilët për sjelljen e tyre individuale ose rrethi familjar ku jetojnë kërkon një ndihmë edukative të specializuar.
- d) Tu vijë në ndihmë të rriturve për mbajtjen e lidhjeve prindërore dhe për një ndihmë edukative.
- e) Të marrë pjesë në trajnimin e aktorëve të veprimit social dhe të favorizojë shkëmbimin reciprok të praktikave të punës.
- f) Të përkrahë dhe tu vijë në ndihmë grave të dhunuara.
- g) Të kryej cdo veprimtari tjetër që nuk pengohet nga kuadri ligjor në fuqi aty ku ky fondacion ushtron veprimtarin e tij.

2. Fondacioni realizon qëllimet e mësipërme me anë të:

- *Mbrojtjes së laicitetit, në atë që ai shpreh respekt për pikëpamjet dhe besimet, por edhe në paralajmërimin e tij kundër ekseseve të qeverisjes apo presionit nga ana e feve mbi menaxhimin e shtetit, dhe së fundmi, për shkak se ai ka për qëllim të luftojë kundër të gjitha formave të fundamentalizmit, ekstremizmit dhe fanatizmit fetar apo ideologjik.*
- a) Bashkëpunimit me insitucione shtetërore dhe/ose private, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare, që kanë qëllime të njëjta në fushën e shërbimeve shoqërore, ekonomike, sociale, shendetësore, kulturore, edukative, etj.
- b) Bashkëpunimit me fondacione, qendra dhe/ose shoqata, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare që kanë qëllime të njëjta në fushën e shërbimeve shoqërore, ekonomike, sociale, shendetësore, kulturore, edukative etj.
- c) Adresimit të fondeve të saj për realizimin e qëllimeve të saj.
- d) Adresimit të financimeve/fondeve të fituara/dhuruara nga institucionet shtetërore dhe/ose private, nga fondacionet, qendrat dhe/ose organizata e ndryshme, kombëtare dhe/ose ndërkombëtare dhe donatorëve privatë.
- e) Pjesëmarrjes së tij, si brenda dhe jashtë vendit, për fitimin dhe/ose pjesëmarrjen e tij në projekte të ndryshme në të mirë dhe interes të publikut për fitimin dhe/ose sigurimin e fondeve dhe financimeve të ndryshme.
- f) Studimeve shkencore, shoqërore, arsimore, shendetësore etj.
- g) Çeljes, organizimit dhe funksionimit të strukturave në mjedis natyror ose qëndrave me qëllim parandalimin, vëzhgimin, pritjen, riedukimin dhe ripërshtatjen e fëmijëve dhe adoleshentëve që u janë besuar.
- h) Krijimit, menaxhimit, organizimit të aktiviteteve kulturore, sportive, etj., që janë të nevojshme për riintegrimin social të fëmijëve dhe adoleshentëve ose të të rriturve që u janë besuar. Për këtë, fondacioni do të sigurojë pjesëmarrjen e të gjithë punonjësve teknikë kompetentë në këto fusha: punonjës socialë, edukatorë të specializuar, psikologë, psikiatër, mjekë të specializuar, etj.
- i) Çeljen dhe menaxhimin e një qendre trajnimi si shkollë për punonjësit e veprimtarisë sociale.
- j) Publikimeve të ndryshme në të gjitha format e mundshme të komunikimit referuar qëllimit të saj në të mirë dhe interes të publikut.
- k) Organizimit, financimit dhe drejtimit të aktiviteteve të ndryshme me qëllim promovimin e vlerave pozitive njerëzore, në fushën e komunikimit njerëzor, integritimit shoqëror etj.
- l) Propogandës, fushatave dhe/ose sondazheve të ndryshme për problemet e ndryshme që kanë lidhje me fëmijët dhe/ose adoleshentët në nevojë që nuk kanë mbështetje ekonomike dhe/ose sociale.

AB



- 
- m) Bashkëpunimi brenda ose jashtë vendit në fusha të ndryshme dhe/ose krijimi i projekteve të përbashkëta në të mirë dhe interes të mbrojtjes së fëmijëve dhe/ose adoleshentëve.
- n) Organizimi i kongreseve, konferencave, kurseve, seminareve, specializimeve, praktikave dhe aktiviteteve të tjera që do të ndihmojnë në relazimin e objektivave dhe qëllimeve të këtij fondacioni.
- o) Dhënie e asistencës teknike organizatave dhe/ose insitucioneve publike dhe/ose atyre private (kombëtare dhe/ose ndërkombëtare) në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.
- p) Bashkëpunimit me organet dhe/ose subjektet shtetërore apo private, si dhe me organizatat e tjera jofitimprurëse për të meshtetur iniciativa shtetërore kombëtare/ndërkombëtare, lokale etj, për të zgjidhur problem specifike në përputhje me objektivat e fondacionit dhe për të ndihmuar në relizimin e programeve të këtij fondacioni.
- q) Të ndërmarë çdo lloj veprimi që është i nevojshëm për tu përgjigjur qëllimeve të Fondacionit në kushtet e parashikuara nga ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### Neni 10

#### Ndalimi i shpërndarjes së fitimeve

1. Fondacioni nuk mund të shpërndajë të ardhura individëve pa shërbim objektiv i lidhur me qëllimin e tij.
2. Asetet, të ardhurat dhe fitimet duhet të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të fondacionit dhe nuk duhet të përdoren për të siguruar përfitime direkte dhe indirekte, për themeuesin, drejtorin/ët, dhe/ose të punësuarit.
3. Bazuar sa më sipër, nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit me përjashtim të zbatimit të detyrimeve ligjore në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve dhe/ose kompesimeve të parashikuara nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me to ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe llogari të këtij fondacioni.

#### Neni 11

#### Kohëzgjatja e fondacionit

1. Fondacioni do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohe të pacaktuar.
2. Fondacioni mund të përfundojë veprimtarinë e tij në përputhje me ligjet shqiptare dhe me këtë statut.
3. Personaliteti juridik i fondacionit mbaron në ditën kur vendimi i Gjykatës për çregjstrimin e tij ka marrë formë të prerë.

#### Neni 12

#### Fondet e Fondacionit

1. Me qëllim themelimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së këtij fondacioni për realizimin e objektit/qëllimeve të përcaktuar, themeluesi i fondacionit ka kontribuar në shumën prej 1000 € (një mijë Euro) ose 139 619 lekë.
2. Me qëllim realizimin dhe mbështetjen e objektit të veprimtarisë dhe/ose qëllimit të tij parashikuar në këtë statut, fondacioni ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie të ligjeshme me kusht që të ardhurat duhen përdorur për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë statut dhe në aktin e themelimit.

AB



3. Të ardhurat e fondacionit do të përfitohen nga aktiviteti i tij ekonomik dhe nga tërheqja e fondeve publike ose private të ndryshme në rrugë të ligjshme.
4. Në të ardhurat e fondacionit përfshihen pasuritë e fondacionit, fondet rezervë të tij, të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i veprimtarive ekonomike, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, fondet, grantet, donacionet e përfituara dhe çdo pasuri tjetër.
5. Për sa i përket pritjeve të fondeve, fondacioni mund t'i sigurojë ato nga fonde grant, donacione të ndryshme të ofruara nga subjektet private dhe/ose publike, vendas apo të huaj.
6. Fondacioni mund të pranojë donacione të ndryshme dhe të hyje në marrëveshje kontraktuale me cdo organizëm tjetër kombëtar apo ndërkombëtar.
7. Përveç sa më sipër, fondacioni ka të drejtë të kryejë veprimtari për mbledhjen e fondeve nëpërmjet mbledhjes publike të tyre, për të përdorur ato për përmbushjen e qëllimeve dhe objektit të veprimtarisë së tij ose për të mbështetur qëllimet dhe/ose veprimtaritë e organizatave të tjera jofitimpruese, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
8. Gjithashtu fondacioni do të marrë pjesë, si të gjithë personat e tjerë juridikë, në fushën e sipërmarrjes, të tenderimit, prokurimit të granteve, të kontraktiveve, të shitjeve etj si nga ana e organeve shtetërore dhe atyre private kombëtare dhe/ose ndërkombëtare.
9. Të ardhurat që do të sigurojë fondacioni do të depozitohen në një llogari bankare e cila do të jetë në emër të Fondacionit "SEA AL".
10. Të ardhurat e siguruara nga cdo vit kalendarik do të projektohen sipas qëllimeve të këtij fondacioni për tu adresuar në vitin pasardhës kalendarik. Këto adresime do të projektohen dhe do të miratohen sipas rregullave ligjore në fuqi dhe dispozitave të këtij statuti.
11. Marrëdhëniet financiare, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta me donatorët realizohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse, duke respektuar kërkesat e ligjore dhe/ose statutore. Ndalohen ndihma materiale ose financiare që jepen për qëllime të kundërligjshme ose që sigurohen nëpërmjet burimeve të kundërligjshme.
12. Fondacioni nuk kryen veprimtari fitimpruese.

Neni 13  
Llogaria Bankare

1. Fondacioni, mbas fitimit të personalitetit juridik, për qëllimet e tij ngarkon Drejtorin Ekzekutiv për çeljen e një llogarie në një nga bankat që ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që të ketë autorizim nga Banka e Shqipërisë.
2. Fondacioni përcakton personin/at e autorizuar që ka/në të drejtë nënshkrimit me bankat si dhe të drejtat dhe kompetencat e tij/tyre në lidhje me këto llogari bankare sipas përcaktimeve të këtij statuti, për raste të vecanta si dhe në mënyrë permanente.

KREU III  
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

Neni 14  
Organet Drejtuese të Fondacionit

1. Organet Drejtuese të Fondacionit "SEA AL" janë:

- a) Bordi i Drejtorëve.
- b) Drejtori Ekzekutiv.

Neni 15  
Bordi i Drejtorëve





1. Bordi i Drejtorëve është organi me i lartë vendimmarrës i Fondacionit "SEA AL" dhe vendos për të gjitha çështjet me përjashtim të atyre që me ligj dhe/ose me statuat ju caktohen organeve të tjera.
2. Bordi vendos gjithashtu dhe për çdo çështje që është në kompetencë të një organi tjetër, çështje për të cilën është kërkuar gjykim i Bordit pas marrjes së vendimit të këtij organi.
3. Bordi i Drejtorëve mbledhet sa herë e kërkon nevoja, të paktën 2(dy) herë në vit, dhe për herën e parë brenda 3 muajve të parë të vitit të ri kalendarik.

#### Neni 16

#### Antarët e Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve të fondacionit "SEA AL" është i përbërë nga 5 persona, të cilët emërohen nga Drejtori i Përgjithshëm i ADSEA01 në ushtrim të mandatit të dhënë nga ADSEA01.
2. Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve është 1 vjeçar; themeluesi mund të rinovojë mandatet pa kufizim kohëzgjatje.
3. Themeluesi ka të drejtë të vendosi për të rritur ose ulur (por gjithmonë jo me pak se 3 anëtarë) numrin e anëtarëve të Bordit kur e sheh të arsyshme dhe në interes të fondacionit. Kandidatura e një anëtari të ri të bordit, përveç atyre ekzistues, propozohet nga themeluesi dhe miratohet nga antarët e Bordit me shumicë votash. Bordi i Drejtorëve ka të drejtë të refuzojë vetëm një herë propozimin dhe me arsyetim të detajuar.
4. Në rast rinovimi të Bordit të Drejtorëve, themeluesi i bën propozimin bordit ekzistues një muaj përpara nga përfudnimit të mandatit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, të cilët brenda tre ditëve nga marrja e propozimit duhet të japin mendimin e tyre.
5. Themeluesi, në çdo moment, ka të drejtë të shpallë shkrirjen e Bordit të Drejtorëve. Bordi i ri i Drejtorëve përcaktohet nga themeluesi dhe konfirmohet nga antarët e rinj të Bordit të Drejtorëve. Themeluesi informon për shkrirjen e Bordit ekzistues një muaj përpara mbledhjes së parë të Bordit të ri të Drejtorëve.
6. Aktualisht Bordi i Drejtorëve përbëhet nga 5 anëtarë si më poshtë vijon:

1. Z. Alain BOUCHON, i biri i Pierre BOUCHON, lindur me 28/01/1964, me banim në 24 avenue des Anciens Combattants 01000 Bourg En Bresse France, identifikuar me pasaportë franceze n ° 06AH74262 , Drejtori i Përgjithshëm, Kryetar i Bordit të Drejtorëve .
2. Zonja Armelle GJONI, e bija e Louis-Paul VIUJARD, e lindur me 28 gusht 1978 në Valence (Francë); me banim në rr. Sami Frasheri - Tirane, 0, C7,2, Tirane 1 ; identifikuar me pasaportë franceze me nr. 14AF55426 ; - anëtare
3. Zonja Vjollca MEÇAJ, e bija e Koço Meçaj, lindur në Durrës më 20 janar 1951, me banim në rruga "Vellezer Manastirliu", pallati 11, ap.9, Tirane, nr. I, identifikuar me letërnjoftim me nr. 024439031; - anëtare.;
4. Zonja Briseida MEMA, e bija e Çezar Mema, lindur në Tiranë më 24 shkurt 1956, me banim në Rruga Muhamet Gjollësja, pallati 69, ap. 28 - Tiranë, identifikuar me letërnjoftim me nr. 025334278, - anëtare;

A03



5. Z. Julien ROCHE, i biri i Marius Roche, lindur në Bourg-en-Bresse (Francë), më 2 korrik 1954, me banim në Twin Tower 1 – Tiranë, identifikuar me pasaportë franceze me nr. 09PT789558; - anëtar

Neni 17

Mbledhjet, kuorumi dhe votimi në Bordin e Drejtorëve

1. Mbledhja e Bordit të Drejtorëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme.
2. Mbledhja e zakonshme e Bordit të Drejtorëve mbledhet dy herë vit.
3. Mbledhja e jashtëzakonshme e Bordit të Drejtorëve mbledhet në rastet e mëposhtme:
  - a) Me kërkesën e themeluesit të Fondacionit
  - b) Në rast se kërkohet nga kryetari i Bordit të Drejtorëve.
  - c) Në rast se kërkohet nga jo me pak se 2 anëtarë të Bordit të Drejtorëve.
  - d) Në rast se kërkohet nga Eksperti Kontabël.
  - e) Per mbledhjet e Bordit të Drejtorëve (të zakonshme apo të jashtëzakonshme), anëtarët lajmërohen me shkrim 2 javë para ditës së mbledhjes.
  - f) Në thirrjen apo kërkesën për mbledhjen e jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve duhet domosdoshmërisht të caktohen çështjet e rendit të ditës, vendi dhe koha si dhe të nënshkruhet nga ata që e kanë thirrur këtë mbledhje. Çdo anëtar i Bordit të Drejtorëve duhet të konfirmojë me shkrim pjesëmarrjen ose jo brenda një jave pas njohjes me thirrjen për mbledhjen e Bordit.
4. Kryetari i Bordit cakton një nga anëtarët për të drejtuar mbledhjen në mungesë të tij.
5. Vendimet merren me ngritjen e dorës. Për çështje personale kryhet votim i fshehtë dhe vetëm nëse një votim i tillë është i nevojshëm.
6. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, që nuk janë të pranishëm, kanë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhje me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i tyre. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar anëtarëve të marrin pjesë në mbledhje, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
7. Bordi i Drejtorëve mbledhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij dhe vendos me shumicë të anëtarëve të pranishëm që kanë të drejtë vote.
8. Në rast mos arritje të kuoromit, thirret një mbledhje tjetër e Bordit të Drejtorëve të njëjtën ditë të javës në vijim, në të njëjtin vend, në të njëjtën orë, pavarësisht nga numri i anëtarëve të pranishëm. Në këtë rast respektohen rregullat e përcaktuara në këtë statut në lidhje me mbledhjen e Bordit të Drejtorëve.
9. Kur mbledhja e Bordit të Drejtorëve nuk është thirrur sipas rregullave të përcaktuara në këtë statut, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë anëtarët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
10. Në thirrjen apo kërkesën për mbledhjen e jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve duhet domosdoshmërisht të caktohen çështjet e rendit të ditës, vendi dhe koha si dhe të nënshkruhet nga ata që e kanë thirrur këtë mbledhje.
11. Në rast se numri i votave pro dhe kundër në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve (e zakonshme dhe e jashtëzakonshme) është i barabartë, vota e kryetarit të Bordit është vendimtare.

Neni 18

A7





## Kompetencat e Bordit të Drejtorëve

1. Bordi i Drejtorëve, në cilësimin e organit më të lartë vendimmarrës, përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej tij, vendos edhe për:
  - a) Politikat bazë të fondacionit.
  - b) I propozon themeluesit vendime për ndryshimin e statutit të fondacionit. Antarët e Bordit të Drejtorëve, të cilët nuk janë themeleues nuk kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në statutin e Fondacionit, këtë të drejtë e ka vetëm themeuesi. Këto anëtarë mund vetëm ti propozojnë themeluesit ndryshime statutores në funksion dhe të mirë të fondacionit dhe mbas miratimit të propozimit të bërë, kanë të drejtë të procedojnë me ndryshimet përkatëse.
  - c) Pëcakton fushat e programet e veprimtarisë si dhe mbikëqyr realizimin e tyre.
  - d) Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit, miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e fondacionit dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm në vazhdim.
  - e) Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe/ose të strukturës së fondacionit.
  - f) Bën emërimin dhe/ose shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv të propozuar nga themeluesi i fondacionit.
  - g) Kontrollon realizimin e detyrave dhe veprimtarinë e Drejtorit Ekzekutiv. Në përfundim i drejton atij një raport të hollësishëm dhe gjithpërfshirës, duke i lënë (kur është rasti) dhe rekomandime të nevojshme.
  - h) Krijon komitete të posaçme.
  - i) Emëron dhe shkarkon Ekspertin Kontabël të fondacionit.
  - j) Emëron likuiduesin e fondacionit kur është rasti.
  - k) Vendos për bashkimin dhe/ose shpërnadrjen e fondacionit duke marrë edhe konfirmimin e themeluesit të fondacionit.
  - l) Autorizon direkt persona për të kryer detyra të caktuara.
  - m) Bën këshillime dhe merr vendime për çështje të ndryshme që ai vendos të shqyrtojë për funksionimin e fondacionit.
  - n) Pika të tjera të parashikuara në dispozitat e ligjit Nr. 8788 , datë 7.02.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar.
2. Pra, ashtu sic përcaktohet edhe më sipër, kompetencat e Bordit të Drejtorëve janë të ndara në tre kategori si më poshtë:
  - a) Kompetencat për ndryshim Statuti.
  - b) Kompetenca me karakter financiar.
  - c) Kompetencat me karakter strukturor.

### Neni 19

#### Të drejtat dhe detyrat e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve

1. Të drejtat e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve janë ato që parashikohen në ligj Nr. 8788 , datë 7.02.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar, dhe në këtë statut, si më poshtë:
    - a) Të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet dhe mbledhjet.
    - b) Të caktojnë dhe të marrin përsipër veprime financiare, për çdo çështje që konsiderohet në përputhje me qëllimet e Fondacionit.
- ASB*



- c) Të bëjnë propozime, kur e gjykojnë të arsyshme, për përmbushjen e qëllimeve të Fondacionit.

2. Detyrimet e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit janë si më poshtë:

- a) Të pranojnë dhe të zbatojnë statutin e fondacionit, aktin e themelimit të tij si dhe vendimet e ligjshme të organeve statutore të fondacionit.
- b) Të mbështesin rregullisht dhe në vazhdimësi Fondacionin, interesat dhe projektin e tij.
- c) Të bashkëpunojnë për relaizimin dhe zhvillimin e qëllimeve të Fondacionit dhe të shmangin cdo lloj veprimi apo aktiviteti që bie ndesh me këto qëllime.
- d) Të sigurojnë që veprimtaria e fondacionit të jetë në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 8788 , datë 7.02.2001 "Për organizatat joftimprurëse" i ndryshuar dhe sa herë që konstaton jopërputhshmëri, ja adreson personave përgjegjës për kryerjen e veprimeve dhe/ose rregullimeve të nevojshme
- e) Nuk përgjigjen për detyrimet e Fondacionit ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve kur gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, i kanë shkaktuar dëm të tretëve.

#### Neni 20

#### Shpërblimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve

1. Funkzioni i anëtarit të Bordit të Drejtorëve është funksion pa shpërblim. Rimbursime të shpenzimeve vetjake janë të mundëshme. Një kompensim aforfe në përputhje me ligjin është i mundshëm për disa nga anëtarët e Bordit me kusht që të ligjërohet me vendim të posaçëm të Bordit të Drejtorëve.
2. Ata shpërblehen edhe në rastet kur përmbushin detyra të caktuara.

#### Neni 21

#### Heqja e të drejtës së Antarësisë

1. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, përveç Kryetarit të Bordit, humbasin të drejtën e antarësisë në rastet e mëposhtme:
  - a) Në rast të përfundimit të mandatit 1 vjeçar kur ky nuk rinovohet nga themeluesi.
  - b) Në rast largimi me dëshirë. Në këtë rast duhet të njoftojë themeluesin të paktën 1 muaj përpara. Në këtë rast ai është i detyruar që deri në momentin e largimit të tij të përmbushë të gjitha detyrimet që ka ndaj fondacionit.
  - c) Mungon pa arsye në mbledhjen (të zakonshme dhe të jashtëzakonshme) e Bordit të Drejtorëve për tre mbedhje rradhazi.
  - d) Në rast vdekje.
  - e) Në rast se përjashtohet nga themeluesi për mosrespektim të statutit dhe programit të Fondacionit.
  - f) Në rast shpërndarje të fondacionit.

#### Neni 22

#### Drejtori Ekzekutiv

1. Organi më i lartë ekzekutiv është Drejtori Ekzekutiv.
2. Ai propozohet nga themeluesi i fondacionit dhe miratohet nga Bordi i Drejtorëve të Fondacionit për një afat kohor 2 vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Në rast se Bordi i Drejtorëve



nuk miraton propozimin e themeluesit për dy herë rrjesht, atëherë Drejtori Ekzekutiv emërohet nga themeluesi.

3. Asnje anëtar i Bordit të Drejtorëve nuk mund të zgjidhet edhe Drejtor Ekzekutiv.
4. Aktualisht Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit "SEA AL", është Z. Edmond BOGDANI, i biri i Todi Bogdanit, i lindur me 25/08/1950, me banim në 8, rue du 4 Septembre 01000 BOURG EN BRESSE – France, n° de passeport 14CY27364, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

### Neni 23

### Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

1. Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit "SEA AL" ka kompetencat si më poshtë :


a) Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës:

- Për vënien në zbatim të përhershëm të politikave dhe realizimin e programeve të përcaktuara nga organet kompetente të Fondacionit,
- Për zhvillimin e marrëdhënieve publike dhe aksionin social të përgjithshëm të Fondacionit,
- Për koordinimin e aktiviteteve të ndryshme, udhëheqjen dhe gjallërimin e studimeve dhe kërkimeve të ndërmarra nga Fondacioni,
- Për funksionimin material dhe financiar të të gjitha mjeteve si dhe nga ana teknike e tyre.

Ky përcaktim i detyrave të Drejtorit Ekzekutiv në tërësinë e tyre përbën një delegim autoriteti mbi:

- b) Shërbimet dhe strukturat e Fondacionit vendosen nën autoritetin e tij. Ai harton raportin vjetor të aktivitetit të strukturave dhe shërbimeve; atij i takon të bëjë vlerësimin e aktiviteteve të tyre nga ana sasiore dhe rregullisht të japë llogari për këtë në Bordin e Drejtorëve.
- c) Ai i propozon Bordit të Drejtorëve projekte shërbimesh duke fiksuar objektiva socio-educativë, si dhe mjetet për realizim dhe vlerësimin e rezultateve.
- d) Drejtori Ekzekutiv vendos për organigramën e personelit në vartësi të projektit të shërbimit të strukturave dhe në funksion të objektivave të Fondacionit, në bashkërendim me Bordin e Drejtorëve.
- e) Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për menaxhimin e personelit me rrogë të strukturave dhe shërbimeve në aspektin juridik dhe administrativ.
- f) Me delegim nga ana e themeluesit, ai merr përsipër të gjitha detyrimet e natyrshme në marrëdhëniet midis punëdhënësve dhe punonjësve.
- g) Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për planin e trajnimit (ai konsultohet me drejtuesit e Shërbimeve dhe Bordin e Drejtorëve), si dhe për zbatimin e buxhetit të trajnimit.
- h) Ai siguron planifikimin kontabël dhe disponueshmërinë e burimeve financiare ndërmjet strukturave dhe shërbimeve.
- i) Ai përfshihet në dosiet që kanë të bëjnë me krijimin e një shërbimi, zgjerimin ose përmirësimin e strukturave me iniciativën e Bordit të Drejtorëve.
- j) Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për informimin e Bordit të Drejtorëve, strukturave dhe shërbimeve dhe aktorët e jashtëm për çështje brenda kompetencave të tij. Ai duhet të sigurojë informimin e Themeluesit dhe Bordit të Drejtorëve për mbarëvajtjen e Fondacionit.
- k) Drejtori Ekzekutiv siguron të gjitha përgjegjësitë e tij në bashkëpunim të vazhdueshëm me Kryetarin e Bordit të Drejtorëve.



- 
- l) Për të siguruar lidhjet e nevojshme në tërësinë e përgjegjësive që ai ka, Drejtori Ekzekutiv merr pjesë me të drejtë vote konsultative në mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
  - m) Drejtori Ekzekutiv përfaqëson Fondacionin, strukturat dhe shërbimet e tij, përpara subjekteve të jashtme në nivelin e kompetencave të tija.
  - n) Drejtori Ekzekutiv, nën përgjegjësinë e tij dhe me miratim të Bordit të Drejtorëve, mund të delegojë një pjesë të përgjegjësive të tija drejtorëve të shërbimeve.
  - o) Të përgatisë të gjitha raportet dhe/ose dokumentet e nevojshme si dhe tja parashtrojë ato Bordit të Drejtorëve.
  - p) Përfaqëson fondacionin përpara subjekteve publike shtetërore dhe/ose private si dhe personave të tretë, si dhe përgatit të gjitha dokumentat e nevojshme që mund të kërkohen nga organet e mësipërme.
  - q) Në mënyrë të veçantë, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të kryejë cdo lloj veprimi me bankat (dhe/ose me institucionet e tjera financiare) në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ose jashtë saj, në funksion të nevojave dhe/ose qëllimeve të Fondacionit.
  - r) Megjithatë, përsa i përket tërheqjes të të hollave, transfertave bankare nga një llogari bankare në një llogari tjetër dhe lëshimin e çeqeve, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të kryejë këto veprime vetëm në rast se vlera e tërhequr ose e transferuar apo e lëshuar me çek nuk e kalon shumën 30.000 euro. Mbi këtë shumë është e nevojshme lëshimi i autorizimit të posaçëm dhe të detajuar si nga themeluesi ashtu edhe nga kryetari i Bordit të Drejtorëve.

Çdo kompetencë tjetër të përcaktuar posaçërisht nga Bordi i Drejtorëve.

#### Neni 24

#### **Përgjegjësia e anëtarëve të organeve drejtuese dhe punonjësve**

Anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive, si dhe punonjësit e fondacionit nuk përgjigjen për detyrimet e tij ndaj të tretëve, me përjashtim të rasteve kur gjatë ushtrimit të detyrës, me dashje ose nga pakujdesia e rëndë i kanë shkaktuar dëm të tretëve.

#### Neni 25

#### **Shpërblimi i Drejtorit Ekzekutiv dhe i punonjësve të Fondacionit**

Drejtori Ekzekutiv si dhe punonjësit e fondacionit për punën e kryer përfitojnë pagë, shpërblime dhe rimbursim për shpenzimet e kryera gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

#### Neni 26

#### **Konflikti i interesave dhe marrëveshjet e ndaluara**

1. Nuk lejohet konflikti i interesave ndërmjet Fondacionit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Drejtorit Ekzekutiv dhe e punonjësve të Fondacionit.
2. Marrëveshjet ndërmjet Fondacionit dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Drejtorit Ekzekutiv dhe punonjësve të Fondacionit, mund të lejohen vetëm nëse ato lidhen për të përmbushur një qëllim ose objektiv të veprimtarisë së Fondacionit, vetëm nëse janë të drejta dhe në përputhje me vlerën reale të tregut. Këto marrëveshje mund të lejohen vetëm nëse shqyrtohen paraprakisht nga organet drejtuese. Personat e interesuar duhet të përjashtohen nga diskutimet dhe votimi për marrëveshjen.
3. Në rast konflikti i interesave ose marrëveshje të ndaluar ose të konsumuar dhe në rast se procedurat e mësipërme nuk janë ndjekur, organizata jofitimprurëse mund ta anulojë këtë marrëveshje dhe të ngrejë padi për dëmshpërblim në gjykatë.

AB



  
Neni 27  
**Zgjidhja e konfliktit të interesave**

1. Çdo anëtar i Bordit të Drejtorëve ose Drejtori Ekzekutiv i fondacionit duhet të tërhiqet nga shqyrtimi dhe marrja e vendimit për çdo çështje që ai ose familjarët e tij kanë interesa të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ekonomike ose vetjakë.
2. Çdo tranzaksion financiar për llogari të Fondacionit, ndërmjet një anëtari të Bordit të Drejtorëve, Drejtorit Ekzekutiv a një punonjësi të fondacionit, si dhe një personi tjetër juridik dhe fizik, kur ka interes financiar, mund të përfundohet vetëm nëse Bordi i Drejtorëve jep miratimin e tij dhe nëse ky tranzaksion përmban kushtet më të favorshme për fondacionin.
3. Punonjësit e paguar nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit. Ata mund të marrin pjesë në mbledhjet e tij si të ftuar pa të drejtë vote.

Neni 28  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve, ndërmjet tyre dhe ekzekutive ose ndërmjet tyre dhe të punësuarve zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me statutin dhe rregullat e Fondacionit, në të kundërt çështja zgjidhet nga gjykata kompetente.

KREU IV  
**LICENCIMI, TË ARDHURAT DHE VEPRIMTARIA EKONOMIKE**

Neni 29  
**Licencimi**

1. Fondacioni për realizimin ose mbështetjen e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së parashikuar në statut, ka të drejtë të ushtrojë çfarëdo lloj veprimtarie të ligjshme.
2. Kur ushtrimi i një veprimtarie paraprihet nga nevoja për marrjen e një lejeje ose licence, fondacioni i paraqet kërkesë organit kompetent, i cili, pasi vëren se ajo i plotëson të gjitha kriteret dhe procedurat përkatëse ligjore, e pajis atë me lejen apo licencën përkatëse.

Neni 30  
**Burimet dhe administrimi i të ardhurave**

1. Burimet e të ardhurave të fondacionit janë fonde, grante dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, nga persona fizikë vendas ose të huaj, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të fondacionit.
2. Fondacioni siguron të ardhura nga burime që njihen nga ligji Nr. 8788, date 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar, dhe bën shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë për të cilët Fondacioni është krijuar, si dhe për menaxhimin e mirëmbajtjen e pasurisë së tij.
3. Të gjitha të ardhurat neto të fituara nga fondacioni, në mënyrat e parashikuara nga ky statut për një vit kalendarik, do të projektohen për tu investuar sipas qëllimit të këtij fondacioni në vitin tjetër kalendarik të ardhshëm.
4. Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e fondacionit prej personave që janë subjekte të këtij statuti dhe/ose të aktit themelues, përveç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose



për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të organizatës jofitimprurëse.

#### Neni 31

#### Veprimtaria ekonomike

1. Fondacioni ka të drejtë të ushtrojë veprimtari ekonomike për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së tij.
2. Fondacioni mund të zhvillojë veprimtari ekonomike pa qenë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për këtë qëllim, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e tij, të jetë deklaruar si një nga burimet e të ardhurave dhe me kusht që kjo veprimtari të mos përbëjë qëllimin primar të veprimtarisë së Fondacionit.
3. Nëse Fondacioni, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, realizon fitime, ato duhet të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit.

#### Neni 32

#### Mbledhja e fondeve dhe marrëdhëniet me donatorët

1. Fondacioni ka të drejtë të kryejnë veprimtari për mbledhjen e fondeve, për t'i përdorur për përmbushjen e qëllimeve dhe objektit të veprimtarisë së tyre ose për të mbështetur qëllimet dhe veprimtaritë e organizatave të tjera jofitimprurëse.
2. Rregullat për mbledhjen publike të fondeve përcaktohen me ligj të veçantë (Qarkore mbi OJF e Ministrisë së Financave nr.9355, datë 22/07/2008).
3. Marrëdhëniet financiare, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella me donatorët realizohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse, por duke respektuar kërkesat e këtij statuti dhe të këtij ligji Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar.
4. Ndalohen ndihma materiale ose financiare që jepen për qëllime të kundërligjshme ose që sigurohen nëpërmjet burimeve të kundërligjshme.

#### Neni 33

#### Dhurimet dhe kontraktimet me organet shtetërore


Fondacioni ka të drejtë të marrë pjesë, si të gjithë personat e tjerë juridikë, në fushën e sipërmarrjes, të tenderimit dhe të prokurimit të granteve, të kontraktimeve dhe të shitblerjeve nga ana e organeve shtetërore të shërbimeve publike, të mallrave dhe të pasurive publike, si dhe të transferimit të shërbimeve publike dhe pasurive përkatëse nga sektori publik tek organizatat jofitimprurëse.

#### Neni 34

#### Detyrimet fiskale dhe mbikëqyrja e fondacionit

1. Fondacioni pavarësisht nga forma e organizimit, qëllimi që ndjek dhe veprimtaritë që ushtron, e përjashton atë nga tatimi mbi të ardhurat.
2. Të ardhurat e realizuara destinohen për veprimtari për të cilat fondacioni është regjistruar, në rast të kundërt, veprimtaria vlerësohet fitimprurëse dhe i nënshtrohet tatimit.
3. Organet kompetente shtetërore kanë të drejtë të mbikëqyrin fondacionin për sa i përket zbatimit të legjislacionit tatimor, doganor, të sigurimeve shoqërore, të lejimit të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, të kontraktimit të ushtrimit të shërbimeve publike e sociale, si dhe për përmbushjen e veprimtarive të tyre me fonde të Buxhetit të Shtetit. AB



  
Neni 35  
Eksperti Kontabël dhe viti financiar

1. Eksperti kontabël zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve dhe është përgjegjës për çështjet ekonomike dhe financiare të Fondacionit, për administrimin e pasurisë së tij duke u kujdesur që të jetë gjithnjë në përputhje me legjislacionin dhe rregullat përkatëse.
2. Ai kontrollon librat financiarë, faturat, dhe të gjitha shpenzimet e tjera të kryera nga Fondacioni.
3. Eksperti kontabël do të qëndrojë në detyrë për një periudhë kohore 1 (një) vjeçare dhe ka të drjetë të rizgjidhet.
4. Në lidhje me aktivitetin e tij, ai është i detyruar të informojë Drejtorin Ekzekutiv çdo 3 muaj ose sa herë t'i kërkohet nga ky i fundit ose nga Bordi i Drejtorëve.
5. Viti financiar i Fondacionit fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të cdo viti, duke bërë përjashtim për vitin e parë.
6. Bilanci financiar i vitit N duhet të përfundohet brenda termujorit të parë të vitit N+1.

Neni 36  
Situata ekonomike, librat dhe regjistrat

1. Në fund të cdo viti fiskal, Drejtori Ekzekutiv përcakton situatën ekonomike dhe administrative, ashtu siç përcaktohet me ligj dhe në përputhje me rregullat e këtij statuti.
2. Bilanci vjetor i dhe shpjegimet përkatëse i jepen për miratim Bordit të Drejtorëve.
3. Bilanci dhe shpjeguesi përkatës duhet të hartohen nga Drejtori Ekzekutiv dhe të bëhen të ditur të paktën 20 ditë përpara mbledhjes së Bordit të Drejtorëve.
4. Fondacioni ruan librat dhe regjistrat e tij siç janë librat financiarë, ku janë të përfshira shpenzimet dhe të ardhurat, si dhe librin e proces-verbaleve për çdo mbledhje. Fondacioni mban gjithashtu dhe regjistrin ku janë të shënuar dhe emrat, adresat dhe pozicionet e anëtarëve të saj. Drejtori Ekzekutiv është i ngarkuar të mbajë dhe të kontrollojë kohë pas kohe rregullsinë e këtyre librave dhe regjistrave.

Neni 37  
Administrata

1. Fondacioni, sipas nevojave të tij, ka të drejtë që përveç personelit të organeve drejtuese të mësipërme të ketë edhe administratë (punonjës) të tjerë.
2. Drejtori Ekzekutiv i paraqet për miratim Bordit të Drejtorëve listën e punonjësve të nevojshëm (duke përcaktuar afatin për nevojën e tyre) në përputhje me veprimtarinë e fondacionit si dhe pagat përkatëse në përputhje me punën që i kërkohet atyre.
3. Punonjësit do të merren në punë nga Drejtori Ekzekutiv sipas legjislacionit në fuqi duke i siguruar të gjitha kushtet e nevojshme të punës dhe sipas nevojës së fondacionit.
4. Marrëdhëniet e punës së Fondacionit rregullohen konform dispozitave të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë dhe/ose çdo vendi tjetër ku fondacion ushtron veprimtarinë e tij.
5. Paga e punonjësve propozohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe miratohet nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 38  
Përfaqësimi ligjor

1. Fondacioni, si rregull, përfaqësohet nga Kryetari i Bordit të Drejtorëve ose Drejtori Ekzekutiv.

AG



2. Në përjashtim të rregullit përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, Drejtori Ekzekutiv i fondacionit mund të kontraktojë për nevojat e fondacionit, pas miratimit nga ana e Bordit të Drejtorëve të emrit dhe cilësisë të atij që delegon, një përfaqësues ligjor të përkohshëm ose të përhershëm, i cili të ketë mbaruar fakultetin e drejtësisë si dhe të ketë një eksperience pune më shumë se 5 vjet në fushën e drejtësisë.
3. Përfaqësuesi ligjor duhet të jetë i pajisur me licencën e avokatit lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë sipas rregullave ligjore në fuqi për vitin që ai kontraktohet.
4. Drejtori Ekzekutiv përcakton pagën/shpërblimin e përfaqësuesit ligjor në kontratën e shërbimit (muja dhe/ose sipas rastit).

KREU V  
**TRANSFORMIMI, BASHKIMI, NDËRPRERJA E VEPRIMTARISË  
DHE SHPËRNDARJA**

Neni 39  
**Transformimi dhe bashkimi**

1. Fondacioni ka të drejtë të transformohet ose të bashkohet vetëm me propozim të themeluesit pas mendimit të Bordit të Drejtorëve, dhe vetëm në rastet se fondacioni tjetër apo qendra ka të njëjten qëllim dhe objektiva me fondacionin dhe kur miratohet edhe nga pala tjetër.
2. Transformimi i fondacionit, bashkimi me një organizatë tjetër jofitimprurëse ose ndarja e tyre, kryhet me propozim të themeluesit dhe me miratim të Bordit të Drejtorëve, kur është e nevojshme.
3. Ndalohet transformimi i Fondacionit në Shoqatë si dhe bashkimi i Fondacionit me një Shoqatë.


Neni 40  
**Shpërndarja**

1. Fondacioni shpërndahet kur:
  - a) ka plotësuar qëllimet dhe objektivat për të cilën është themeluar.
  - b) vendoset shpërndarja e vullnetëshme sipas propozimit të themeluesit dhe pas shqyrtimit në Bordin Drejtues.
  - c) në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 8788, date 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
2. Gjykata mund të vendosë shpërndarjen e fondacionit me kërkesë të themeluesit të saj, të organeve të saj vendimmarrëse, të organit shtetëror kompetent në rastet kur:
  - a. veprimtaria e fondacionit vjen në kundërshtim me Kushtetutën;
  - b. fondacioni kryen veprimtari të kundërligjshme;
  - c. fondacioni nuk është themeluar sipas kërkesave të ligjit Nr. 8788, date 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar, ligjit Nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" si dhe dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
  - d. Fondacioni ka falimentuar sipas ligjit për falimentimin.
  - e. Përveç rasteve kur veprimtaria e fondacionit përbën kërcënim serioz për publikun, gjykata duhet të lajmërojë me shkrim atë për shkeljen e ligjit dhe t'i japë asaj 30 ditë për të korigjuar veprimtarinë e saj.

AB



3. Për shpërndarjen e fondacionit janë të aplikueshme edhe përcaktimet e nenit 45 të ligjit Nr. 8788, date 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" i ndryshuar.

  
KREU V  
**LIKUIDIMI, ÇREGJISTRIMI DHE DISPOZITAT TRANZITORE**

Neni 41

**Likuidimi dhe veprimtaria e tij**

1. Kur shpërndarja vendoset nga themeluesi, likuidimi realizohet nga një ose disa likuidatorë, të caktuar sipas statutit dhe kurdoherë përpara çregjistrimit nga gjykata.
2. Kur shpërndarjen e vendos gjykata, ajo cakton edhe likuidatorin, duke e veshur me kompetencat e nevojshme për zhvillimin e procedurës së likuidimit.
3. Në të gjitha rastet, likuidatorët kanë autoritetin dhe përgjegjësinë mbi asetet, pasurinë dhe përfaqësimin e fondacionit, që nga dita e emërimit të tyre dhe deri në përfundimin e likuidimit.
4. Likuidatori bën vlerësimin e gjendjes financiare të fondacionit dhe të pasurisë së saj në çastin e marrjes së vendimit për shpërndarjen e saj, si dhe evidenton të gjithë kreditorët e debitorët e mundshëm. Pas pagimit të detyrimeve që fondacioni i ka shtetit dhe kreditorëve të tjerë dhe marrjes së detyrimeve nga të tretët, likuidatori vlerëson pasurinë e mbetur dhe kujdeset që kjo pasuri të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga statuti, organi kompetent i saj, gjykata ose ligji. Në asnjë rast nuk lejohet shpërndarje ose disponimi në favor të anëtarëve ose personave të tjerë që janë subjekte të statutit ose të aktit të themelimit të organizatës ose të të afërmeve të tyre me përjashtim të themeluesit "ADSEA01". Në rastet kur fondacioni ka përfituar përjashtim nga taksat apo lehtësira fiskale, donacione nga publiku ose grante shtetërore, çdo pasuri e mbetur pas pagimit të detyrimeve i shpërndahet themeluesit "ADSEA01" i cili mund tja japë organizatave të tjera jofitimprurëse që ndjekin qëllime të njëjta ose të ngjashme me organizatën e likuiduar. Në rastet kur një Fondacioni shpërndahet vullnetarisht, organizatat përfituese të pasurisë së mbetur përcaktohen në statut ose me një vendim të organit më të lartë vendimmarrës. Kur ky përcaktim nuk është bërë, organizatat përfituese përcaktohen nga gjykata.

Neni 42

**Çregjistrimi**

1. Kur shpërndarja është vendosur nga vetë fondacioni, organi kompetent sipas statutit, miraton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe kërkon nga gjykata çregjistrimin e fondacionit.
2. Në rastet kur organi kompetent i fondacionit nuk miraton shpërndarjen dhe raportin përfundimtar të likuidatorit ose kur likuidimin e ka vendosur gjykata, kjo e fundit, në seancë gjyqësore në prani të përfaqësuesve të fondacionit dhe të likuidatorit, shqyrton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe merr vendim për çregjistrimin e tij.

Neni 43

**Dispozita Tranzitore**

1. Ky statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të Fondacionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Rrethit të Tiranës dhe në këtë dite Fondacioni njihet edhe si person juridik.
2. Ky statut, u hartua nga themeluesi në Tiranë më datë 6 nëntor 2014 në 4 (katër) ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.



3. Pas leximit dhe gjetjes në rregull ai nënshkruhet me vullnet të plote pa verejtje nga themeluesi.
4. Per ç'ka s'është shprehur në këtë Statut, u referohemi ligjeve në fuqi si dhe cdo ligji tjetër shqiptar dhe/ose joshqiptar që ka të bëjë me organizatat jofitimprurëse - fondacionet.

THEMELUESI I FONDACIONIT

Alain BOUCHON

*Alain Bouchon*



*[Handwritten signature]*

**ADSEA de l'Ain**

Direction Générale  
526 rue Paul Verlaine  
01960 PERONNAS

Tél. : 04.74.32.55.91 - Fax : 04.74.32.55  
www.sauvegarde01.fr

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 3240 Rep.

Nr. 1154 Kol.

V È R T E T I M

Sot me date 06 Nentor 2014 (dymije e katermbedhjete), para meje Arjana R. MALLKUÇI, Notere ne qytetin Tirane, me zyre ne Rr. " Vaso Pasha " pall. 13/1, u paraqit personalisht :

Z. Alain BOUCHON, i biri i Pierre BOUCHON, lindur me 28/01/1964, me banim në 24 avenue des Anciens Combattants 01000 Bourg En Bresse France, identifikuar me pasaporte franceze n ° 06AH74262 , me cilesine e Drejtorit te Përgjithshem, Kryetar i Bordit të Drejtorëve, te Fondacionit SEA AL, Tirane,

i cili ne prani te Perkthyesit Z. Edmond Bogdani, nenshkroi rregullisht para meje Statutin e Fondacionit SEA AL, dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.

Perkthyes

*[Handwritten signature]*  
Edmond BOGDANI

NOTERE

*[Handwritten signature]*  
Arjana R. MALLKUÇI

